

V E N D I M
Nr.2, datë 9.1.1995

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.528, DATË
17.10.1994 “PËR MËNYRËN E PAGESËS SË BANESAVE QË FINANCOHEN NGA ENTI
KOMBËTAR I BANESAVE”**

Me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Brendshme dhe Shërbimit Informativ Kombëtar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 528, datë 17.10.1994, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: “Për banesat në proces të Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Brendshme dhe SHIK-ut, të përfunduara me fondet e Entit Kombëtar të Banesave, këto dikastere hartojnë listat e punonjësve të tyre që do të strehohen në këto banesa dhe ia dërgojnë Entit Kombëtar të Banesave për lidhjen e kontratave provizore të shitjes së apartamenteve. Këto dikastere duhet të zbatojnë aktmarrëveshjet që qytetarët kanë me pushtetet lokale për efekt të planeve rregulluese”.

2. Në pikën 4 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: “Për banesat e Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Brendshme dhe SHIK-ut është në kompetencë të këtyre dikastereve të caktojnë punonjës të tjerë të tyre për të zëvendësuar punonjës të refuzojnë të paguajnë për blerjen e apartamentit”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi